



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

THIRRJE PËR NOMINIME NGA OSHC-TË PËR PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE NË KOMITETIN NACIONAL KORDINUES NË KUADËR TË OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP –OGP

THIRRJA ËSHTË E HAPUR PËR 13 PËRFAQESUES TË SHOQËRISË CIVILE

Me nismën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e pesëmbëdhjetë ka marrë vendim që të krijohet Komiteti Nacional Koordinues që për mandate ka hartimin e Planit Nacional të Veprimit 2022-2024 në kuadër të [Open Government Partnership –OGP](#). Open Government Partnership –OGP (Partneriteti për Qeverisje të Hapur – PQH) është një mekanizëm ndërkombëtar e cila për synim ka promovimin e mirëqeverisjes, qeverisjes së hapur dhe transparente, qeverisjen elektronike, llogaridhënien, luftën kundër korrupsion dhe ngritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Në këtë kontekst për Republikën e Kosovës është shumë e rëndësishme përgatitja dhe anëtarësimi në këtë organizatë. Për tu anëtarësuar duhet që Komiteti Nacional Koordinues të hartojë Planin Nacional të Veprimit 2022-2024.

Komiteti Nacional Koordinues do të përbehet nga institucionet publike, shoqëria civile (me shumicë anëtarësh), sektori i biznesit, organizata dhe institucione relevante vendore e ndërkombëtare.

Duke pas rëndësinë e këtij procesi dhe arritjes së gjithëpërfshirjes në këtë proces është e domosdoshme dhe luan një rol kyç përfshirja e organizatave të shoqërisë civile të nivelit qendror dhe lokal në proces. Për këtë Sekretariati i CiviKos do të lehtësoj procedurat e përzgjedhjes së organizatave dhe individëve sipas Rregullores së Punës të CiviKos.

Kriteret

1. Aktive më shumë se dy vite në sektorin e shoqërisë civile;

2. Aktive në fushën kundër korrupsion (të dokumentohet më aktivitete specifike);
3. Aktive në fushën e promovimit të transparencës institucionale (të dokumentohet më aktivitetet specifike);
4. Aktive në fushën e promovimit të teknologjisë së inovacionit për përmirësimin e shërbimeve publikë;
5. Aktive në fushën e llogaridhënies së institucioneve publikë;
6. Aktive në fushën e promovimit të hapjes së të dhënave institucionale (open data);
7. Aktive në fushën e promovimit të pjesëmarrjes së qytetrëve në vendimmarrje.

Për të nominuar një kandidat/e, OSHCja duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. CV të kandidatit/es që organizata e nominon;
2. Certifikatën e regjistrimit të organizatës;
3. Dëshmi rreth misionit dhe përvojës së organizatës (jo më shumë se 1 faqe A4)

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes email: info@civikos.net, ose në zyrat e Platformës CiviKos Rr. Bedri Pejani 7/A 10000 Prishtinë.

Afati për dorëzimin e dokumenteve është shtyer deri më 27.08.2021, ora 16:00.

SHENIM: Kjo thirrje është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Kosovë dhe nuk limitohet në anëtarësinë në Platformën CiviKos.

Në Rast të Procedurave të Votimit

Në rast se kemi më shumë se 1 kandidat që i plotësojnë kriteret atëherë do të shkohet me procedura të votimit, sipas Rregullores së Punës të CiviKos. Kandidater që marrin më së shumti vota do të përzgjidhen anëtar të Komitetit Nacional Koordinues.

Pas përfundimit të nominimit, paneli i përbërë nga një përfaqësues i Sekretariatit të Platformës CiviKos, një anëtar i Bordit të CiviKos dhe një përfaqësues i MAPL-së do të verifikojë nëse kandidatët e nominuar i plotësojnë kriteret e kërkuara. Të gjithë kandidatët që konstatohet që i plotësojnë kriteret e kërkuara do të përfshihen në listën përfundimtare për votim.

Menjëherë pas përpilimit të listës përfundimtare për votim, të gjitha OShC-të e regjistruara mund të votojnë për kandidatët e tyre të preferuar brenda një afati prej 5 ditësh nga hapja e procesit të votimit. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, postë të rregullt ose personalisht në zyrën e CiviKos. Votuesit mund të votojnë në mënyrë anonime me hedhjen e votës së tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos-it. Në cilëndo mënyrë të votimit, fletëvotimit duhet t'i bashkëngjitet edhe kopja e certifikatës së regjistrimit të organizatës.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos. Pas zgjedhjeve, Komisioni shqyrton dhe numëron fletëvotimet dhe përcakton se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse

dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, vendi si përfaqësues i OShc-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të reflektuar diversitetin shoqëror dhe të shoqërisë civile në Kosovë, inkurajohet nominimi i femrave, anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë dhe grupeve të nënpërfaqësuar.